REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
19.03.2019
01-060/01-285

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42 paragrafi 42.3 i Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, ne Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës se Vitisë, Nr 01-013/594, e datës: 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-III-**, të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **22.03.2019 ( e Premte)**, duke filluar në ora 10,oo.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e drejtorit të Drejtorisë për Administratë në objektin e Komunës së Vitisë. Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 70.000 € për pagesën e obligimit të fshatrave Goshicë dhe Gërmovë për projektin e ujësjellësit dhe kanalizimit.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Azem Bislimi (Rrustem).**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim pronën e paluajtshme e Komunës së Vitisë në shfrytëzim afatshkurtër për ndërtimin e Shtëpisë së pleqëve në zonën kadastrale në Letnicë.**
6. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2019.**
7. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve ne vendimmarrje për vitin 2019.**
8. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit për komunitete për vitin 2019.**

**Viti, më 19.03.2019**

**Me respekt !**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Naim Pira**

REPUBLIKA KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VITISË - OPŠTINA VITINA
KUVENDI KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE
1

# PROCESVERBAL
## I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.02.2019(e Enjte)**, në Zyrën e Drejtorit të Administratës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal). znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së për këtë vit. A ka dikush pyetje jashtë rendit të ditës?

**z.Bekim Azizi:** Unë isha lidh te festimi i ditës së pavarësisë, kam vërejtje te seanca solemne, se ajo është e Kuvendit Komunal dhe mendoj se duhet të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal. Tana manifestimet vazhdojnë, është që seancat e radhës të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Vërejtje me vend, por si po bahen neper salla po ecin njerëzit, ajo ka qenë arsyeja kryesore, se përndryshe nuk na pengon absolutisht asgjë.

**z.Jakup Demiri:** Nuk e di kush i ulë, por edhe kësaj radhe nuk është respektua, ku ne si Lëvizje Vetëvendosje, me 28 nëntor kemi qenë në rendin e 5, ku gjithë kemi pas vërejtje prej kryetarit nuk po vinë, edhe kjo nuk na pëlqeu, edhe ne d.m.th mos me mbajt bashkë mu dit ku mbahet seancë solemne.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Desha vetëm të ju sqaroj, se ka pas një këshill organizativ dhe në të kanë qenë krejt subjektet politike. Po që se do të ishte prezenca e juaj dhe do të ishin dhanë sugjerime nga qysh kish marr vendim këshilli, kishim vepruar. Neve po na mban ajo frika, se në data të rëndësishme si po përfundon seanca solemne edhe po bëhen homazhe, sikur po e nënçmojmë këtë pjesën tjetër që është me ja kushtuar Ditës së Pavarësisë, por nuk do të jetë problem, në festat që do të vinë do ta shqyrtojmë dhe do ti rregullojmë ashtu sië na duket ma se miri.

**z.Bekim Azizi:** Megjithatë unë mendoj, se kuvendi vendos a me mbajt seancë solemne, nuk vendos këshilli organizativ, ajo mbahet me këshilltar komunal e mbajmë në sallën e Kuvendit Komunal.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka dikush tjetër ndonjë pyetje, atëherë për këtë mbledhje kemi paraparë këtë:

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2018.**
3. **a) Nisma e Kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore, kulturore, sportive dhe shoqërisë.**
   **b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës**

Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.

c) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.

4. Propozim për ndryshimin e vendimit Nr.01-410/03-71, i datës 08.02.2018 të KKSB-së me kërkesën e Forcës së Sigurisë së Kosovës.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të komunës Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar dëshmorit Safet Rexhepi nga Zhitia.

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm?

**z.Bekim Azizi:** Na në seancën e kaluar i shtyhem pasqyrat financiare, a na ka bërë ndonjë material shtesë?

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Unë kisha një kërkesë, se e diskutuam, se për shkak të procedurave na u ka kthy edhe për Komunën e Kirchaimit. Na si propozim vendim na e kemi të miratuar në seancën e kaluar, na i ka dhanë ministria do vërejtje që duhet me i përmirësuar edhe me qu përsëri në Kuvend.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** E miratojmë rendin e ditës dhe në fund e shikojmë. Kush është që të miratohet ky rend dite me këto pika. Konstatoj se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

A ka dikush rreth procesverbalit ju lutëm, nëse nuk ka e qesim në votim. Konstatoj se me vota unanime u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2018**

Ia kisha kaluar fjalën drejtorit rreth kësaj pike.

**z.Ibrahim Rama:** Të nderuar anëtarë, në mbledhjen e kaluar nga ju kam pasur disa kërkesa për shënime shtesë. Unë i kam përgatitur, kjo ka të bëjë me analitiken e të gjitha punëve të kryera, që kanë të bëjnë me projektin e asfaltimit të rrugëve rurale. Unë i kam përgatit dhe para se me fillua unë po ja u dërgojë nga një kopje për me qenë sa ma komplete pasqyrat financiare. Unë po ja u jap edhe një fletë të ja bashkëngjitni në fund që në kuvend të jenë sa ma të kompletuar. Për të tjera nuk do me ju marr ma shumë kohë, pasi materialin e keni marrë me kohë, për ndonjë pyetje apo sugjerim jam ne dispozicion të ju përgjigjem.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem.

**z.Bekim Azizi:** Unë kisha fillua prej këtyre që na i ke sjellë shtesë, p.sh.: faqe 24, asfaltimi i rrugëve rurale. Janë lyp shënimet me nr. 14 që janë në tabelë, paraqiten atje, që asfaltimi i rrugëve rurale, e para 14 "Rahovica Komerce", rruga Smirë-Kabash-Lubishtë, e kështu me radhë edh këtu te nr. 23, Radivojcë-Devajë e me radh. Edhe në fund Smirë. Këtu Smirë nuk ka një planë të rrugëve që kanë me u shtruar, nëse të kujtohet para 5-6 muaj që kanë me u shtruar, ma ke sjell, edhe këtu shënohet që ka pas me u shtrua në Smirë tri rrugë, a në teren nuk ka rrugë të shtruar në Smirë këtë vit. Si thojke atë ditë kryetari në seancë, emërtimi i projektit, zgjerimi i rrugës Drobesh – Mogillë, veç emrin e ka ashtu, se tjetër send kemi bërë. E tash nuk kam mund me krahasuar me këtë çka kemi planifikuar, që ma ke dhanë që janë shtruar vetëm te Smira. U kyqa, se e di që nuk janë shtruar. Te mirëmbajtja e ndriçimit publik, 24 mijë euro, me të vërtetë mu dokë shumë e madhe. Furnizimi me material të shtypur 16880 euro. Nuk i kisha të kjartë çfarë materiali shtypet, çfarë furnizime, kodi 13 610. Këtë

drejtor, kontratat me shërbime të veçanta. Qëta si material shtesë që është 102 mijë euro, faleminderit që na i paske sjellë.

**z.Jakup Demiri:** Këtu te taksat e bizneseve, 314 mijë euro, kisha kërkuar një sqarim prej drejtorit, janë taksa të komunës këto, por edhe niveli qendrorë e ka një për faljen e taksës, unë për vete kam abstenuar.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Më fal se po të ndërpre, po kjo ka qenë vendim i marr nga legjislatura e kaluar. Na e kemi marr vendimin për me hek taksen jo për me ju a falë.

**z.Jakup Demiri:** Kisha dashtë edhe një sqarim për rrugët e Smirës që figurojnë këtu, dhe nuk janë të kryera, se na e dimë gjendjen në teren dhe nuk ka pas asfaltime të rrugëve në Smirë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush tjetër me diskutua rreth kësaj pike të rendit të ditës ju lutëm, nëse nuk ka, ja kisha kaluar fjalën drejtorit të na përgjigjet rreth këtyre pyetjeve.

**z.Ibrahim Rama:** Asfaltimi i rrugëve rurale, mos përputhja tekstuale e Bekimit, se jo financiare, se financiare përputhet raporti që e kam bërë shtesë me pasqyrat financiare me cent, po aty titulli kushtohet ku përmendet Smira. Aty në raport nuk shkrun që ka rrugë të Smirës. Projektet deri këtë vit nga ky vit na i ka kufizuar ministria, nuk ka projekte dyvjeçare përveç atyre që teknikisht janë të pamundura mu realizua brenda një viti, d.m.th gjitha projektet kanë me përfunduar me 31.12.2019. Vitet e kaluara ju e keni votuar buxhetin, edhe keni qenë të informuar që disa projekte kanë qenë të natyrës, janë planifikuar për dy vite, kanë qenë asfaltime të rrugëve, rregullime të shkollave edhe në vitin 2018 kemi bërë projekte që kanë konotacion edhe në vitin 2019. Aty Beka që e ceki në projekt, janë edhe rrugët e Smirës. Aty një pjesë është kryer një pjesë ka mbetur me u krye, këtë vit ato janë të planifikuara edhe me buxhet. Një pyetje ishte, shuëen e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, ajo ka ndodhë saktë në bazë të faktuarve, ajo është një shpenzim që ka ndodhë. Një informatë, Komuna e Vitisë e ka vendin e parë për ndriçim në nivel vendi, kurse sa i përket pyetjes për material të shtypur, kjo ka të bëjë me materialin që është shtypur enkas në kompaninë, ka të shtypura materiale të ndryshme, nëse keni nevojë me ja u sjellë edhe një raport mundem me sjellë. Edhe një pyetje për taksen e biznesit Jakupi që e bëri, unë e shpjegova edhe në fillim, thash, kjo është një taksë, komuna e ka vendosë, kena besuar edhe hala besojmë sikur ka marr vendim kuvendi me hekë edhe se ka mospërputhje ligjore, se kur e kanë bërë ligjin mbi faljen e borxheve nuk e kanë precizuar as nuk kanë thanë askund që komuna duhet me i fal borxhet e vjetra. Kështu që në këtë aspekt është një konfuzion i zgjidhjes politike të kësaj takse, jo vetëm për Vitinë, por për krejt komunat.

**z.Jakup Demiri:** Kjo që do të them, nuk ka të bëjë me drejtorin, por me Komunën e Vitisë. Komuna e Vitisë ma e ndriçuar në vend në aspektin tjetër është komuna ma e varfër. Vitin e kaluar një takim që e kemi pasur në Smirë me Komunën e Kirchaimit, unë edhe Tefiku. Na e kemi pasur një ide me ba shkollën e Smirës me panele polare. Një vit përpara ja kemi dhanë idenë edhe kur biseduam që ishin herën e fundit edhe kur I pyetëm për ata far projekti, profa na tha juve nuk po ju dufke energji, se kishi boll. Thanë a prodhojmë rrymë që s'mundemi me hargjua. I kemi dy pika aty, na pimë kafe, ndërsa vetura mbushet me rrymë tha profi, por ndriçimin publik, thanë atë fshat na e kemi, ku pritet transporti publik, edhe aty janë me cenzor. Vjen udhëtari prit, hec, ndalet, ajo e jo sit e ju keni quar ndriçim publik deri në mal, kështu na tha tekstualisht.

**z.Ibrahim Rama:** Ndriçimi është i mirë, me thanë të drejtën ju me ardh me i shikua kërkesat e qytetarëve, nuk ka fshatë, lagje që nuk kërkon ndriçim publik, edhe neve na I ka marr mendja që është punë e mirë edhe sa kemi pas mjete financiare kemi nda edhe mjete për ndriçim publik.

**z.Jakup Demiri:** Sa janë të arsyeshme nuk po e konteston askush, se politiken nuk e bënë qytetari, ai nuk e dinë qa ndodhë brenda atij, ju duhet qajo dritë edhe shkon bënë kërkesë. Unë jam tu thanë se ke ndriçim publik edhe ku nuk ke banim hiq me njerëz edhe dhezën 18:00 deri në 06 të mëngjesit.

**z.Bekim Azizi:** Megjithatë unë mendoj si një qytetar në periferi si ai në qendër e ka atë, por për mua është shqetësim shuma prej 26 mijë euro. Na e kemi rastin në Smirë kur janë vendosur dritat. Prej 40 dritave të vendosura 26 kanë qenë të djegura, ajo është shqetësim për mua ku prishen brenda muajit. Megjithatë këtë listën që ma ka sjellë në fund, kjo te shërbimet e veçanta e kam veç një emër, Hazire Frangu profesoreshë në shkollën e mesme profesionale, punon qe 7-8 vite te na, pse kjo me shërbime të veçanta.

**z.Ibrahim Rama:** Jo, kjo është tjetër person, nuk është ajo për të cilin po mendoni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Atëherë, nëse nuk ka, unë ju falënderoj të gjithëve që dhatë kontribut rreth kësaj pike.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

3. a) **Nisma e kryetarit të Komunës së Vitisë, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe**

**bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.**

**b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.**

**c) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë**

Ne kemi vizituar, atje ishte një numër i madh i banorëve të Vitisë që ishin në atë qytet. Unë po mendoj se është një nismë e mirë, nuk po e zgjasë ma shumë. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm.

**z.Bekim Azizi:** Është kanë mirë me na I sjell një përshkrim, kush është kjo komunë, sa banorë ka, në cilin vend është, se me të thanë të drejtën as emrin nuk ja kisha ni, të paktën ne me pas një përshkrim edhe me ditë çka mundemi me bashkëpunuar na me atë komunë. Kjo është mirë, se paska banorë të Vitisë, por me naj bë edhe një statistikë me e lidhë interesi me Vitinë, të paktën me pas një informatë çka jemi duke bërë.

**z.Jakup Demiri:** Edhe unë desha me u ndërlidh me këtë. E di që Vitia ka pas banor me nënshtetasi kroate, se fshatrat malore janë zbrazë dhe kryesisht janë shkuar në Kroaci, por nuk e di unë çfarë lloj bashkëpunimi mundemi me bërë dhe kam shumë dilema qa me bërë të paktën me pas një para hyrje me shikua aspektin ekonomik, a kulturor, a sportiv. Qa mundemi me bashkëpunuar, edhe do komuna e kanë praktikë se kur shkojnë për vizita e marrin edhe opozitën edhe unë për vete nuk jam i interesuar as edhe me votuar.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Në aspektin profesional nuk mundet me shënuar ndryshe. Në aspektin plotësues, që kërkoj Bekimi, për një përshkrim të shkurtër të asaj komune, çfarë karakteristika ka, sa është numri I banorëve, na mundemi me përgatitur atë që mundet me qenë material shtesë, por në propozim vendim ato nuk mundet mi cekë, ato janë të ndara në prefektura dhe komuna. Komunat janë shumë ma të vogla me nr. të banorëve, diku mbi 2 mijë banorë është në prefekturën e Blerovarës, aty është një numër i konsiderueshëm i shqiptareve të cilit sipas ligjit të Kroacisë duhet m plotësuar numrin për me pas drejtë me formuar një këshill të komunitetit, por megjithatë ne do ta sjellim një historiat të kësaj komune.

**z.Jakup Demiri:** Desha vetëm një sqarim. Në këtë informatë nuk po shkrun askund që ka shqiptar, se e shpjegoi tash nënkryetari, po ne po ju referohemi këtyre dokumenteve që i kemi para. Te e dyta, Arbeni nuk ka qenë pjesë e shoqërisë, kur nuk ka qenë hiq atje.

**z.Bekim Azizi:** Na me këtë po i bëjmë autorizim kryetarit, për me bë marrëveshje bashkëpunimi në nivel shtetërorë. Këto marrëveshje a vinë prapë në Kuvend dhe me na pru edhe një material shtesë për biografinë e kësaj komune.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Nga ana ligjore duhet të shkohet në këtë mënyrë, s'ka tjetër, na vetëm se nuk I kemi ndjekë këto procedura, na ka kthy ministria vendimin e Komunës së Kirchainit.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Po e qesë në votim këtë pikë të rendit të ditës që të shkoj për kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

4. **Propozim për ndryshimin e vendimit Nr.01-410/03-71 i datës: 08.02.2018 të KKSB-së me kërkesën e Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Është kërkesë e FSK-së që të ndërrohet anëtari.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Nga udhëzimi administrative I KKSB-së shkojnë personat sipas detyrës zyrtare, andaj na nuk e kemi shti atë emër, Forca e Sigurisë na I ka dërguar dhe tash për shkak të ndërrimit të pozitës sjell dikon tjetër.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** E hedhi në votim që të shkoj në kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë tjetër kemi:

5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për kompenzimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane**

Na e kemi sjell një propozim vendim të tillë, në mënyrë që këta anëtar që i kemi emëruar na si komitet. Është e udhës të kompensohen, sepse ata po duhet me shkua pas orarit të punës. Aspekti ligjor është krejt në rregull. Hapi debatin, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm? Vetëm një sqarim, se këtu janë 5 anëtar, se hynë edhe një anëtar i këshillit të fshatit.

**z.Jakup Demiri:** Ma të arsyeshme e shohë që ai që zgjidhet administrator me pas një 50 euro, se sa ai që është anëtar i komisionit. Unë mendoj, se nëse komuna po mundet me pagu dikan nga fshati që hynë në komision, unë nuk e di pse nuk mundet me pagua këta që po them unë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Ajo është diçka tjetër. Na po flasim sot për komisionin, se edhe për ta duhet me ba diçka, se ka kaluar koha e vullnetarizmit.

**z.Bekim Azizi:** Kam një pyetje, se unë pash edhe agjendën, ishin diku 26 ditë që kishin mi mbajt, tash 50 euro është mëditja për një person.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar, a jeni që të shkoj edhe kjo pikë në Kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të komunës Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti.**

Ja kisha kalua fjalën drejtoreshës ta paraqet këtë pikë të rendit të ditës.

**znj.Majlnda Ostrogllava:** Me këtë propozim vendim, propozohet t'i jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme e Komunës së Vitisë, sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti, pa procedurë të konkurrimit. Për ma shumë, materialin e keni para vete, nëse ka dikush ndonjë pyetje apo sqarim jam në dispozicion të ju ndihmoj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**z.Jakup Demiri:** Vetëm desha të pyes pa procedura a e lejon ligji?

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Jam interesuar, çështja e bashkësive fetare, çështja e ambasadave të huaja, investimet në energji elektrike, çështje të cilat janë të rregulluara me ligj.

**z.Bekim Azizi:** Këtë tokë vetëm e kanë në shfrytëzim ata, unë kisha thanë, u kanë mirë mi nxjerrë të gjitha fshatrat, pronat për varreza në këtë formë që nuk janë të definuara mirë. A kish ba me një propozim vendim me ardh këtu edhe me një vendim mi kthy krejt sikur këtë që po e kthejmë, mos me ardhë çdo seancë edhe le të dihet pronësia e atyre.

**znj.Gjylsime Qamili:** Unë vetëm një korrigjim do ta bëjë këtu, drejtoresh, se u pajtova se janë përcjell procedurat ligjore të gjitha, po këtu mos të figuroj në Katundi I Ri, se nuk e di a është në listë, le të përmirësohet që mos të shkoj me këtë gabim.

**znj.Majlnda Ostrogllava:** Në sistem në zonën kadastrale figuron zyrtarisht Katundi i Ri, nuk e njehë në mënyrë tjetër.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka dikush tjetër, kush është që edhe kjo pikë të shkoj në kuvend? Konstatoj se edhe kjo pikë shkon në Kuvend.

Dhe si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar dëshmorit Safet Rexhepi nga Zhitia**

**znj.Majlnda Ostrogllava:** Me këtë propozim vendim, propozohet të vendoset lapidari i dëshmorit Safet Rexhepi nga Zhitia në Viti, sipas kërkesës të Këshillit Koordinues të Fshatit Zhiti. Vetëm një sqarim për kuvend vjen shtatore, se kur e kanë bërë kërkesën ata u kanë e dyshimtë a lapidar a shtatore, kështu që në kuvend vjen me përmirësim. Për ma shumë, materialin e keni para vetës, për pyetje përgjigje mund të diskutojmë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm.

**z.Bekim Azizi:** Vendi saktë ku ndërtohet shtatorja është te QKMF-ja, a I bjen ka ambulanta a në anën e kundërt.

**znj. Majlnda Ostrogllava:** Sigurt i bien ka ambulanta, është në park të ambulantes.

**z.Jakup Demiri:** Është pak temë e ndjeshme, por na këtu jemi edhe për tema të ndjeshme. Unë i kisha ba ftesë Kuvendit Komunal edhe Kryetarit edhe shoqërisë civile, që ta organizojmë një debat me qytetar për këto probleme, se dorën në zemër, dikush këtu e dikush atje u ba larmoni kjo farë pune. Ai që po ka forcë po e banë, ai që nuk ka nuk po e banë, edhe kjo po më duket se është e tepërt ma. Çdo respekt për gjithë ata që kanë vdek, por edhe ata që kanë bërë një ditë mundi po më duket që e prishmi imazhin edhe të atij që e vendosim aty, se tybe ma shumë kanë me sha qytetaret kur ta shohin aty. Unë propozoj që urgjentisht na me marr iniciativën dhe me qenë ma serioze me bë një tryezë edhe të diskutojmë këtë problematikë në komunën tone.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Shumë çështje se the edhe unë pajtohem plotësisht, por kemi edhe emërimin që kemi bërë te rrugëve dhe të sesheve. Nëpër sheshet ku janë emëruar mundemi me e vendosë edhe me atë pajtohen që nuk kanë ra ata për me ju vendos përmendore. Tash, drejtoresha, si ti vie një kërkesë është obligative me qitë propozim vendimin, se kërkesa ekziston. Na mundemi me kaluar, por ka shumë mundësi që ministria përkatëse mundet me na i kthy. Kryesuesi sa ka pas qare pa e qitë në KPF.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Na si procedurë e kemi përfillë, e kemi sjell, tash është çështje e kuvendit atje, mund t`i diskutojmë sendet nëse nuk është vullnet I kuvendit, nuk e miratojmë, po nëse është OSBE një praktikë që e ka ndjekë Gjilani, kur familjet kërkojnë me ngrit shtatore apo bust, komuna ka bërë rregullore, ku përcakton lokacionin ku kanë me qenë lokacionet, ku mundet me u shfrytëzua vendosjet e lapidareve. Edhe tjetra është, cilët janë emrat që nuk janë përfaqësuar në Komunë e Vitisë. Mund të them se është e ndjeshme çështja e lapidareve dhe Komuna e Gjilanit ka një praktik të mirë, pasi që ka pas probleme të tilla.

**z.Bekim Azizi:** Është vendim I rëndësisë, që çdo propozim vendim që vjen I tillë unë e votoj, por është veprim jo mirë që ka ardhur. Kam qenë në komision për emërtimin e rrugëve, ka qenë komisioni që nëse e ka një shkollë mos me pas një rrugë, e kemi thy, ata e mbajnë dyjat. Fatkeqësisht në Viti I kanë vendosë edhe privatisht I kanë qitë para aktit të kryer organet komunale. Kanë qenë tema të rënda s'kanë mund as me ndërhyer, është çështja e shkollës së Gushicës, qe 10 vite busti I rregulluar nuk kanë lejuar me ndreq, por fatkeqësisht dikush e ka mundësinë me depërtuar shumë letë, dikush nuk e ka atë mundësi.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë po e qesë për kuvend këtë çështje, a jeni me shku në Kuvend dhe kuvendi e merr vendimin. Konstatoj se me vota unanime shkon në kuvend. Dhe një po ju lus, a ta dërgojmë me material të kuvendit edhe propozim vendimin e Kirchaimit. Unanimisht jeni pro. Faleminderit, mirë u pafshim në seancat e radhës.

Mbledhja përfundon në ora: 12:00

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi:**<br>**Fatlum Demiri**<br>______________ | **Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë**<br>**z.Naim Pira**<br>______________ |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljeno: 08-03-2019
02-035/02-231

Republika e Kosovës | Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

# PROPOZIM VENDIM

## PËR BARTJEN E MJETEVE NGA TË HYRAT VETANAKE TË VITIT 2018 NË VITIN 2019

### I.

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin për bartjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara të vitit 2018 në vitin 2019.

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-133 –Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 9 - të ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura , pika 1,2 , bilancet e pa shpenzuara të të hyarve vetanake të komunave, për Bartjen e Buxhetit Komunal në shumë prej **105,765.31** € të vitit 2018 në vitin 2019 .

### II.

Bartja e Buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike :
1. Paga e mëditje në shumë prej 1,500.00 €
2. Mallëra e shërbime në shumë prej 26,229.73 €
3. Subvencione e transfere në shumë prej 14,081.57 €
4. Investime kapitale në shumë prej 63,954.01 €

**Të shpërndara në këto programe – nën programe buxhetore :**

Në kategorinë ekonomike **paga dhe mëditje** shuma prej **1,500.00 €,** në programin :

Shëndetësi dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi **shërbimet e shëndetësisë primare** (74950) shuma prej 1,500.00 €.

Në kategorinë ekonomike **mallëra dhe shërbime** shuma prej **26,229.73 €,** në programet si vijon:

Zyra e Kryetarit (160) nën-programi **zyra e kryetarit** (16033) shuma prej 63.81 €.
Administrata (163) nën-programi **administratë dhe personel** (16333), shuma prej 49.14 €.
Shërbimet publike, mbrojtja emergjente (180) nën-programi **infrastruktura publike** (18193) shuma prej 25,072.09 €.
Kultura ,rinia e sportet (850) nën-programi **shërbimet kulturore** (85033), shuma prej 954.02 €.
Arsim dhe shkenca ( 920) nën-programi **arsim parashkollor dhe qerdhet** (92850 ) shuma prej 90.67 €.

Në kategorinë ekonomike **Subvencione dhe transfere** shuma prej **14,081.57 €**, në programet si vijon:

Zyra e kryetarit (160) nën-programi **zyra e kryetarit** (16033) shuma prej 318.00 €.
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural (470) nën-programi **bujqësia** (47033) shuma prej 1,199.00 €.
Kultura ,rinia e sportet (850) nën-programi **shërbimet kulturore** (85033) shuma prej 1,804.57 €.
Shërbimet sociale dhe rezidenciale (755) nën-programi **shërbimet sociale – Viti** (75661), shuma prej 10,760.00 €.

Në kategorinë ekonomike **shpenzime kapitale** shuma prej **63,954.01 €**, në programet dhe projektet, si vijon:

Buxhet e financa (175) nën-programi **buxhetimi** (17533) shuma prej **62,954.01 €** në projektet:

1. " Revitalizimi i stadiumit në Pozheran e Viti ", kodi (45474) shuma prej 1,305.04 €.
2. " Asfaltimi i rrugëve rurale ", kodi (41593) shuma prej 1,176.67 €.
3. " Rregullimi i rrugëve me zhavor ", kodi (41600) shuma prej 1,777.34 €.
4. " Rregullimi i kanalizimeve dhe gropave septike ", kodi (46872) shuma prej 30,000.00 €.
5. " Participim i projekteve me donator ",kodi (90552) shuma prej 28,123.83€.
6. " Rregullimi i kanalizimeve ",kodi (41597) shuma prej 203.13 €.

Shëndetësia dhe mirëqenja sociale (730) nën-programi **Shërbimet e shëndetësis primare** (74950) shuma prej **1,368.00 €** në projektin:

1. " Furnizim me aparatura dhe digjitalizim " kodi (46847) në shumë prej 1,368.00 €.

Forma tabelare **Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2018 në vitin 2019**

| Programi/ Nënprogrami | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Fondi Burimor | Kategoria ekonomike | BARTJA 2018 |
|---|---|---|---|---|---|
| Shërbimet e shëndetësis primare | 74950 | 0721 | 22 | 11 | 1,500.00 |
| **Paga dhe mëditje** | | | | | **1,500.00** |
| Zyra e kryetarit | 16033 | 0111 | 22 | 13 | 63.81 |
| Administrata dhe personeli | 16333 | 0133 | 22 | 13 | 49.14 |
| Infrastruktura Publike | 18193 | 0451 | 22 | 13 | 25,072.09 |
| Shërbimet kulturore | 85033 | 0820 | 22 | 13 | 954.02 |
| Arsimi parashkollor dhe qerdhet | 92850 | 0911 | 22 | 13 | 90.67 |
| **Mallera dhe shërbime** | | | | | **26,229.73** |
| Zyra e kryetarit | 16033 | 0111 | 22 | 20 | 318.00 |
| Bujqësia | 47033 | 0421 | 22 | 20 | 1,199.00 |
| Shërbimet kulturore | 85033 | 0820 | 22 | 20 | 1,804.57 |
| Sherbime sociale - Viti | 75661 | 1040 | 22 | 20 | 10,760.00 |
| **Subvencione e transfere** | | | | | **14,081.57** |
| Buxhetimi | 17533 | 0112 | 22 | 30 | 62.586,01 |
| Shërbimet e shëndetsis primare | 74950 | 0721 | 22 | 30 | 1,368.00 |
| **Kapitale** | | | | | **63,954.01** |
| **Shuma totale** | | | | | **105,765.31** |

**Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2018 në vitin 2019 nga kategoria e shpenzimeve kapitale**

Komuna: Viti 657

| Programi | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Fondi Burimor | Kategoria ekonomike | Nën kategorit ekonomike (zërat) | Pershkrimi i nënzerit | Kodi i projektit | Projektet | BARTJA 2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Buxhetimi | 17533 | 0112 | 22 | 30 | 31124 | Objekte sportive | 45474 | Revitalizimi i stadiumit në Pozheran e Viti | 1,305.04 |
| Buxhetimi | 1753 | 0112 | 22 | 30 | 31230 | Ndërtimi i rrugëve lokale | 41593 | Asfaltimi i rrugëve rurale | 1,176.67 |
| Buxhetimi | 1753 | 0112 | 22 | 30 | 31230 | Ndërtimi i rrugëve lokale | 41600 | Rregullimi i rrugëve me zhavor | 1,777.34 |
| Buxhetimi | 17533 | 0112 | 22 | 30 | 31250 | Kanalizimi | 46872 | Rregullimi i kanalizimeve dhe gropave septike | 30,000.00 |
| Buxhetimi | 1753 | 0112 | 22 | 30 | | | 90552 | Participim i projekteve me donator | 28,123.83 |
